

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË KORÇË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Korçë me objekt: “Mbi zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në menaxhimin financiar dhe kontrollin, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit lokal të kësaj bashkie, në hartimin, miratimin e respektimin e strukturës organike dhe të nivelit të pagave sipas klasifikimit të funksioneve, në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, në administrimin e vlerave materiale e monetare, në prokurimin e fondeve publike, në programimin e realizimin e të ardhurave vendore, në fushën e urbanistikës etj’.” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 144, datë 30.9.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 575/10 , datë 30.9.2012 , dërguar z. **Niko Peleshi**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të hartohen e miratohen akte të brendshme administrative për të siguruar ngritjen dhe zbatimin e rregullave për kontrollin e brendshëm.

Vazhdimisht

2. Të punohet për implementimin e procedurave antikorrupsion, bazuar në legjislacionin në fuqi. Nëpunësi autorizues dhe menaxherët e tjerë të institucionit të bashkëveprojnë për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.

Vazhdimisht

3. Në asnjë rast nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të mos veprojnë me fondet e bashkisë, në veçanti për investime, për të cilat nuk janë miratuar më parë objektet nga Këshilli i Bashkisë.

Vazhdimisht

4. Për tenderin me objekt “Sistemim e asfaltim rrugë e trotuare lagja nr. 7” të zhvilluar në vitin 2009, me kontraktues ████████ sh.p.k, i cili nuk është marrë në dorëzim për shkak se cilësia e punimeve lë për të dëshiruar, të evidentohen, saktësohen punimet që janë kryer pa cilësinë e duhur dhe të negociohet me ████████ sh.p.k për kryerjen e tyre deri në vlerën 1,462,522 lekë, e cila përfaqëson vlerën 5 për qind të garancisë së punimeve të situacionuara. Në rast mos dakordësie kjo vlerë të prokurohet rishtazi me OE të tjerë.

Menjëherë

5. Të ndiqet dhe të përfundohet në ZVRPP Korçë, procesi i regjistrimit të asetëve pronë e Bashkisë dhe të bëhet evidentimi i tyre në kontabilitet.

Vazhdimisht

6. Të bëhet analiza dhe saktësimi i gjobave të Policisë së Bashkisë, për subjektet që përfitojnë falje, me qëllim saktësimin e detyrimit të mbetur në zbatim të dispozitave ligjore.

Menjëherë

7. Të merren masa që të ardhurat e parashikuara në paketën fiskale nga Këshilli i Bashkisë, të cilat nuk janë planifikuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të planifikohen e të arkëtohen në vitin në vazhdim.

Menjëherë

8. Të merren masa dhe të ndiqet me përparësi arkëtimi i taksës së tokës, e cila për vitin 2011 llogaritet në vlerën 722,550 lekë, kurse për periudhën 01.01.2008 deri 31.12.2010 është 2,167,000 lekë.

Menjëherë

9. Të merren masa dhe të ndiqet me përparësi arkëtimi i tarifës së zënies së hapësirave publike, e cila për vitin 2011 llogaritet në vlerën 398,250 lekë, kurse për periudhën 01.01.2008 deri 31.12.2010 llogaritet 1,057,000 lekë.

Menjëherë

10. Të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore, për 216 subjekteve debitorë në vlerën 26,186,322 lekë për vitin 2011 dhe për 820 subjekte debitorë me vlerë 84,518,000 mijë lekë për periudhën 01.01.2008 deri 31.12.2010.

Menjëherë

11. Të paraqiten në llogaritë debitorë dhe në bilancin kontabël, detyrimet e pa arkëtuara nga taksat vendore të vitit 2011 dhe të periudhave të mëparshme.

Menjëherë

12. Të përcaktohet dokumentacioni për të vërtetuar saktë vleftën e subvencionit për transportin urban bazuar në numrin e personave që kanë udhëtuar falas si invalidë, veteranë dhe studentë të cilët udhëtojnë me ½ e vlerë së biletës. Subjekti [REDAKTUAR] të paraqes raportin vjetor të aktivitetit të ekspertuar sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2 e 7 të udhëzimit përbashkët të MPPTT nr. 360/5, MF nr 666/5 dhe MPVD nr. 1663, datë 27.02.2000 “Për transportin e udhëtarëve”.

Menjëherë

13. Të kryet regjistrimi i çeljes së fondeve nga të ardhurat sipas kriterëve të përcaktuara në kapitullin V klasa 7 të VKM 783 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

Menjëherë

14. Të sistemohen saktësisht në inventar dhe në kontabilitet sipas analizave “Aktivet qëndrueshme të trupëzuara” kryesisht llogaritë “Ndërtesa”, “Toka, troje, terrene”, “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” të cilat prej vitesh paraqiten vetëm me vlerën e rikonstruksioneve e sistemeve të kryera.

Menjëherë

15. Të kërkohet dhe të ndiqet me përparësi arkëtimi i detyrimeve sipas rekomandimeve të KLSH prej vitit 2004 e në vazhdim, në shumën 35,534,112 lekë.

Menjëherë

16. Për pesë automjete në pronësi të bashkisë me vlerë 10,516,830 lekë gjithsej, për të cilat nuk disponohet dokumentacion, të verifikohen të përcaktohet gjendja teknike, dhe për mangësitë të nxirret përgjegjësia.

Menjëherë

17. Autoriteti Vendor i Planifikimit të marrë masa, për vlerësimin dhe rishikimin, e strukturës dhe formatit të PPV, në përputhje me ligjin e ri, pasi përfundimi i rishikimit dhe miratimit të PPV-së është detyrim ligjor dhe i hap rrugën zhvillimit të territorit në mënyrë të qëndrueshme, me qëllim që shqyrtimi dhe miratimi i lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit dhe lejeve të përdorimit, të bëhet duke u bazuar në kërkesat e ligjit për planifikimin dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Menjëherë

18. Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të fillojë procesin e inventarizimit dhe të arkivimit, të dosjeve përkatëse të lejeve të ndërtimit dhe lejeve të shfrytëzimit, si dhe vendosjen e tyre në arkivin urban.

Menjëherë

19. Autoriteti Vendor i Planifikimit të marrë masa për hartimin e miratimin e instrumenteve të planifikimit në nivel vendor dhe ndër vendor, si PZHNjV, Plani Përgjithshëm Vendor për Planifikimin e Territorit dhe Rregullorja e Planifikimit për PPV, si detyrim ligjor për të gjitha njësitë vendore.

Menjëherë

20. Autoriteti Vendor i Planifikimit të marrë masa, që lejet e ndërtimit të miratuara para hyrjes në fuqi të ligjit të planifikimit dhe lejet e ndërtimit që janë në zbatim, të vazhdojnë zbatimin e tyre në përputhje me kushtet e lejes së dhënë.

Vazhdimisht

21. Autoriteti Vendor i Planifikimit të marrë masa, që ndërtimet e përfunduara para hyrjes në fuqi me efekte të plota të ligjit për planifikimin e territorit, lejen e përdorimit (leja e shfrytëzimit) ta marrin në përputhje me kushtet e zbatimit të lejes së ndërtimit të miratuar.

Vazhdimisht

22. INUV të merren masa, për hartimin e programeve të punës vjetore dhe në mbështetje të tij, të përgatisë programet mujore, si dhe të evadojë kthimin e përgjigjeve në lidhje me ankesat e ardhura.

Menjëherë

23. INUV në bashkëpunim me Zyrën Përmbartimore, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 10,850,000 lekë, për 18 raste të gjobave të vendosura, nga të cilat 850,000 lekë për 3 raste në vitin 2011 dhe 10,000,000 lekë për 15 raste në vitin 2008-2010.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Të kërkojen në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **31,361,346 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

Për vitin 2011 vlera 6,301,928 lekë, nga të cilat:

- 1,440,664 lekë shtatëdhjetenjë punonjësve, të cilëve ju është paguar leja vjetore e vitit 2010 në vitin 2011, në kundërshtim me pikë 1/d të VKM nr. 472, datë 2.7.2011.

- 3,030,000 lekë subjektit [REDAKTUAR] për shkak të mos arkëtimit të qirasë dhe penaliteteve, në zbatim të kontratës lidhur midis palëve.

- 563.400 lekë operatorit ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k, për shkak të qirasë së pa paguar dhe penaliteteve.

- 237,500 lekë subjektit [REDAKTUAR] sh.p.k, fitues në tenderin me objekt “Vendosja e orëve në qytet”, për shkak të hartimit të preventivit dhe likuidimit, në kundërshtim me pikën 7 të UKM nr. 2, datë 08.05.2003 ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

- 52,104 lekë subjektit [REDAKTUAR] sh.p.k si diferencë e përfituar tepër për operacionin “larje konteinerësh” në zbatim të kontratës datë 7.3.2011, për periudhën 7.3.2011 deri 31.8.2011.

- 255,720 lekë [REDAKTUAR] sh.p.k në cilësinë e sipërmarrësit në tenderët me objekt “Sistemim – asfaltim blloku i banimit 17/1, vazhdimi” dhe “Sistemim – asfaltim blloku i banimit 16/1, vazhdimi”,

- 613,240 lekë [REDAKTUAR] sh.p.k në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i Shkollës së Mesme R. Qirinxhi”,

- 109,300 lekë [REDAKTUAR] sh.p.k në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt

“ Rikonstruksioni i pallatit nr. 10”, për shkak të likuidimeve të punimeve të pakryera në 4 tenderë, në kundërshtim me nenet 7, 8, 9, 11, 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, pikën 17 dhe 19 të kreut të I, pikat 3/a, 3/b dhe 3/c të kreut të II të UKM nr. 3, datë 15.2.2001, me pikat 3/4, 7/1 dhe 7/3 kreu i I, pikat 2, 2/1 dhe 4 kreu i III të UKM nr 2, datë 13.5.2005.

Për periudhën 01.01.2008 deri më 31.12.2010 vlera 25,059,418 lekë, nga të cilat:

- 1.955.980 lekë [REDAKTUAR] sh.a në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Sistemim rrugë dhe gjelbërim, lagja nr. 18”,

- 611.550 lekë [REDAKTUAR] sh.p.k dhe [REDAKTUAR] sh.p.k në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Sistemim rrugë + trotuare, Lagja nr. 6”, për shkak të likuidimit të punimeve të pakryera, në kundërshtim me nenet 7, 8, 9, 11, 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, pikën 17 dhe 19 të kreut

të I, pikat 3/a, 3/b dhe 3/c të kreut të II të UKM nr. 3, datë 15.2.2001, me pikat 3/4, 7,/1 dhe 7/3 kreu i I, pikat 2, 2/1 dhe 4 kreu i III të UKM nr 2, datë 13.5.2005.

- 1,003,008 lekë [REDACTED] sh.a në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Sistemim e asfaltim rrugë e trotuare lagja nr. 1 dhe 2”, për shkak të likuidimeve të kryera në kundërshtim me pikën 4 të kreu-t III, të UKM nr. 2, datë 13.5.2005.

- 2,192,700 lekë [REDACTED] sh.p.k në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Sistemim e asfaltim rrugë e trotuare lagja nr. 7”, për shkak të likuidimeve të punimeve të pakryera, në kundërshtim me pikën 4 të kreu-t III të UKM nr. 2, datë 13.5.2005; mos kryerjen e punimeve sipas projektit dhe specifikimeve teknike të miratuar në DST etj.

- 9,600,000 lekë subjektit [REDACTED] në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Studimi, projektimi për bonifikimin e fushës ekzistuese të mbetjeve të ngurta urbane”, për shkak të likuidimeve të punimeve të pakryera, në kundërshtim me shtojcën 17, faqe nr. 63, me emërtim “Termet e referencës” të DST miratuar nga AK; “Propozimin ekonomik”, Preventivin e detajuar, të sjellë nga subjekti fitues etj.

- 195,607 lekë pesëmbëdhjetë punonjësve të policisë bashkiake dhënë shpërblim nga gjobat e arkëtuara gjatë vitit 2008 dhe 2009 në kundërshtim me lidhjen nr. 2 të VKM nr. 551, datë 7.11.2002 dhe pikën 5 të VKM nr. 432, datë 28.6. 2006.

- 58,944 lekë për tre punonjës për pagesa të kryera në vitin 2010 për ditët e pushimeve vjetore të vitit 2009 në kundërshtim me pikën 1/c të VKM nr. 591, datë 23.7.2010.

- 294,233 lekë [REDACTED] e cila përfaqëson pagesën e kryer ndaj Zyrës Përmbarimore Korçë, për shkak të mos zbatimit vullnetar të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në pesë raste.

- 196,534 lekë katër mbikëqyrësve dhe kolaudatorëve të punimeve, paguar më tepër gjatë viteve 2008, 2009 dhe 2010 në kundërshtim me VKM nr. 444, datë 5.9.1994.

- 857,542 lekë katër subjekteve, për shkak të mos pagimit të qirasë të objekteve të biznesit, sipas kushteve të kontratës lidhur midis palëve.

- 6,452,515 lekë këshilltarëve të bashkisë, për pagesa të kryera për udhëtime jashtë shtetit në kundërshtim me VKM nr. 103 datë 4.2.1998, V KM nr. 304 datë 08.05.2003 dhe ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005.

- 600,000 lekë [REDACTED] Korçë, për pagesë të kryer në kundërshtim me ligjin nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet” dhe për mos zbatim të nenit 5/3 të akt marrëveshjes datë 30.12.2009 lidhur midis palëve..

- 1,040,805 lekë subjektit [REDACTED] sh.p.k për shkak të llogaritjes së gabuar, e cila paraqitet në formën e diferencës midis përqindjes së vlerës së preventivuar të investimit në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit dhe vlerës së situacionit përfundimtar të objektit, në kundërshtim me nenin 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 i ndryshuar.

C. MASA ADMINISTRATIVE.

Mbështetur në nenin 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X , t’i kërkohet APP-së, të vendosë gjoba në masën 50,000 lekë për personat e mëposhtëm:

1. [REDACTED] me detyrë kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
2. [REDACTED] “ “ anëtare njësisë së prokurimit
3. [REDACTED] “ “ “ “ “ “
4. [REDACTED] “ “ “ “ “ “

Për shkeljet e konstatuara në prokurimet publike të kryera gjatë vitit 2011, në tenderët si më poshtë:

a. “Sistemim – Asfaltim blloku i banimit Lagja nr. 17/a” (vazhdimi), i fituar nga operatori ekonomik (OE) [REDACTED] sh.p.k pasi:

- Formularët e deklaramit të ofertës të OE fitues, nuk janë të shoqëruar me analizat tekniko – financiare në kundërshtim me pikën 3/12 “Llogaritja e çmimit”, të DST të miratuar nga AK.

- [REDACTED] sh.p.k nuk ka kapacitetin e nevojshëm teknik për kryerjen e punimeve në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të kërkuar AK.

b. “Sistemim – Asfaltim blloku i banimit Lagja nr. 14”, i fituar nga [REDACTED] sh.p.k pasi:

- Formularët e deklaramit të ofertës të OE fitues, nuk janë të shoqëruar me analizat tekniko – financiare në kundërshtim me pikën 3/12 “Llogaritja e çmimit”, të DST të miratuar nga AK.

- Në tre OE që kanë paraqitur oferta, dy prej tyre [REDACTED] sh.p.k dhe [REDACTED] sh.p.k nuk kanë kapacitetin e nevojshëm teknik për kryerjen e punimeve në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të kërkuar AK.

Mbështetur në sa më sipër, në kushtet e mungesës së konkurrencës AK duhet të anulonte procedurën e tenderit dhe të fillonte një procedurë të re.

c. “Rikonstruksion pista e stadiumit” Korçë, i fituar nga [REDACTED] pasi:

- Nuk kanë punë të së njëjtës natyrë me objektin që prokurohet, i cili zë rreth 70 % të vlerës që prokurohet, në kundërshtim me Kriteret e veçanta të Kualifikimit të DST të miratuar nga AK.

- Formularët e deklaramit të ofertës nuk janë të shoqëruar me analizat tekniko - financiare në kundërshtim me pikën 3/12 “Llogaritja e çmimit”, të DST të miratuar nga AK.

Parregullsitë e përshkruara më lart ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave.

d. “Sistemim – Asfaltim blloku i banimit Lagja nr. 15/1” (shtesë kontrate), i fituar nga [REDACTED]

e. “Sistemim – Asfaltim blloku i banimit Lagja nr. 16/1” (shtesë kontrate), i fituar nga [REDACTED]

Për të dy tenderët, AK ka ndjekur procedurën “Me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës” në kundërshtim me pikën 5 “Procedura me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës” paragrafi 11 i KREU –t të V *Llojet dhe përzgjedhja e procedurës*, të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, i cili përcakton se procedura me negociim, pa botim paraprak të kontratës, mund të përdoret në rastet...e zgjatjes së kontratave të shërbimeve ose punëve, nëse nevoja për punë/shërbime shtesë është shkaktuar nga rrethana të paparashikuara, që nuk varen nga AK dhe që nuk mund të ndahen, teknikisht ose ekonomikisht nga kontrata fillestare, pa sjellë ndikime negative në ose në kosto të mëtejshme për AK, por që janë të nevojshme për përfundimin e kontratës fillestare dhe ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit.

Zgjedhja e procedurës së tenderit “Me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës” në prokurimet e përshkruar më lart, e ndjekur nga AK, nuk përfshihet në asnjë nga rastet e parashikuara.

f. “Studimi, projektimi për bonifikimin e fushës ekzistuese të mbetjeve të ngurta urbane të qytetit Korçë” të zhvilluar në vitin 2008, të fituar nga subjekti [REDACTED] me vleftë të kontratës së lidhur 19.968.000 lekë, pasi nuk argumentohet mënyra e llogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me pikën 2/c të Kreu –t II Rregullat e përgjithshme të prokurimit, të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 i ndryshuar dhe ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit.

-Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III-të “Sanksionet” nenet 15 e 16, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor, të **gjobisë** mbikëqyrësit e punimeve të ndërtimit,

5. [REDACTED] me 100,000 lekë, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderëve me objekt:

- “Sistemim rrugë dhe gjelbërim, Lagja nr. 18” Korçë të zhvilluar në vitin 2008, likuiduar më tepër për punime të pakryera, [REDACTED] sh.a vlera **1.955.980 lekë** .

- “Sistemim rrugë + trotuare, Lagja nr. 6” Korçë të zhvilluar në vitin 2008, likuiduar në të cilin i janë më tepër për punime të pakryera ██████ sh.p.k dhe ██████ sh.p.k vlera **611.550 lekë**.
- “Sistemim e asfaltim rrugë e trotuare lagja nr. 1 dhe 2” Korçë të zhvilluar në vitin 2008, në të cilin i janë likuiduar më tepër për punime të pakryera ██████ SH A vlera **1,687,983 lekë**.
- “Sistemim e asfaltim rrugë e trotuare lagja nr. 7” Korçë, të zhvilluar në vitin 2009, në të cilin i janë likuiduar më tepër për punime të pakryera ██████ sh.p.k vlera **2,192,700 lekë**.

2. Zj. ██████ me 50,000 lekë, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderit me objekt:

- “Rikonstrukcion shkolla e mesme “R.Qirinxhi” të zhvilluar në vitin 2011, në të cilin i janë likuiduar më tepër ██████ sh.p.k vlera **613,240 lekë lekë**.

Veprimet e kryera prej tyre bien në kundërshtim me nenin 4, paragrafi parë, Kreu II-të, neni 7 paragrafi tretë, neni 8 paragrafi dytë, neni 9 paragrafi tretë shkronja “c” dhe neni 12 paragrafi parë pikat 1,2,3 dhe 4 të Kreut III-të, të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Mbi kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshime; me piken 4 paragrafi tretë, pika 5/c dhe 15 paragrafi i dytë, pika 17 dhe 19 të Kreut I-rë, pikat 3/a, 3/b dhe 3/c të Kreut II-të të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” dhe pikat 3/4, 7, 7/1 dhe 7/3 Kreu I-rë dhe pikat 2, 2/1 dhe 4 të Kreut III-të të udhëzimit KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a) “Vërejtje me shkrim”, neni 25, pika 3, germa a

1. Zj. ██████ me detyrë Drejtore e Drejtorisë Juridike,

2. Z. ██████ me detyrë jurist në Drejtorinë Juridike,

3. Z. ██████ me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Aseteve për shkak se:

- Kanë lënë në përdorim pa pagesë për vitin 2011 objektin “Zyra në varrezat publike” me sipërfaqe 240 m² dhe nuk kanë lidhur kontratë qiraje me ██████ sh.p.k,
- Nuk kanë ndjekur arkëtimin në kohë të vlerës së qirasë së truallit prej 400 m² sipas kushteve të kontratës me ██████ dhe nuk kanë aplikuar penaltitetet për ditë vonesat sipas kushteve të kontratës,
- Nuk kanë arkëtuar në kohë qiranë e objekteve të biznesit dhe nuk kanë aplikuar penaltitetet sipas kushteve të kontratës, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 i ndryshuar dhe ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008.

Krahas sa më sipër, veprimet bien ndesh dhe me nenin 11, 12 të ligjit nr. 10 296, datë 8.07.2010.

b) “Vërejtje me paralajmërim”, neni 25, pika 3, germa b

1. Z. ██████ me detyrë specialist i infrastrukturës inxhinierike në vitin 2009 dhe 2011,

2. Z. ██████ me detyrë përgjegjës i sektorit të ligjshmërisë në cilësinë e kryetarit të komisionit të inventarizimit pasurisë për vitin 2010, për shkak se nuk kanë kryer të plotë inventarin fizik Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara, në kundërshtim me ligjin nr. 6942 datë 25.12.1984 “Për administrimin, dokumentimin, ruajtjen e qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, Kreu V “Inventarizimi i vlerave materiale” nenet 18, 20, 21 pikat a,b,c dhe nenin 11 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

3. Z. ██████ me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike,

4. Z. ██████ me detyrë Përgjegjës në Drejtorinë e Menaxhimit të Kontratave, për shkak se për marrjen në dorëzim dhe administrimin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara automjetet, për vitin 2010, kanë vepruar në kundërshtim nenin 11 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

5. Z. [REDACTED] me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Regjistrimit ne Drejtorinë e të Ardhurave Vendore,

6. Zj. [REDACTED] me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Mbledhjes së të Ardhurave Vendore për periudhën 2010 deri 2011, për shkak se:

- Ka planifikuar me rezerva dhe nuk ka rakorduar taksat nga popullata për pastrimin, pasurinë, ndriçimin, gjelbërimin dhe hapësirat publike për vitet 2008 deri 2011.

- Nuk ka ndjekur arkëtimin e tarifës së tokës bujqësore për periudhën 2008 deri 2011,

- Nuk ka zbatuar procedurat ligjore ndaj debitorëve për vitin 2008 dhe 2011, për veprime të kryera në kundërshtim me nenin 45, 46, të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999, si dhe nenin 32 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemimin e taksave vendore” i ndryshuar.

7. Z. [REDACTED] me detyrë përgjegjës i Sektorit të Kontrollit të Tokës, në cilësinë e ish-përgjegjës të Sektorit të Kadastrës Urbane.

8. Zj. [REDACTED] me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Zhvillimit të Tokës, në cilësinë e ish-përgjegjës së Sektorit të Sekretarisë Teknike,

- për mos zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës” i ndryshuar, dhe Udhëzimit të KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërtimeve” i ndryshuar.

- për parregullsi e mangësi, në zbatimin e procedurave ligjore në shqyrtimin e miratimin e studimeve urbanistike pjesore, lejeve të destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij, lejeve të ndërtimit, në mbajtjen e akteve të kontrollit sipas fazave të ndërtimit, si dhe në shqyrtimin dhe dhënien e lejeve të shfrytëzimit.

c) “Kalimi në një detyrë të një klase më të ulët për një periudhë 1 vit”, neni 25, pika 3, germa c

1. Z. [REDACTED] me detyrë Drejtor i Drejtorisë të Menaxhimit të Kontratave për shkak:

- Të mangësive dhe parregullsive të konstatuara në tenderin me objekt “Studimi, projektimi për bonifikimin e fushës ekzistuese të mbetjeve të ngurta urbane” të qytetit Korçë të zhvilluar vitin 2008, të fituar nga subjekti “Qendra Kombëtare e Lëvizjes Ambientaliste”.

- Se nuk ka kërkuar nga operatori i shërbimit të transportit urban, deklaratat e pasqyrit të shpenzimeve dhe të të ardhurave të realizuara, si dhe raportin vjetor të aktivitetit të ekspertuar në kundërshtim pikat 2 dhe 7 të Udhëzimit të përbashkët të MPPTT, MF dhe MPVD, “Për transportin e udhëtarëve”.

2. Z. [REDACTED] me detyrë Drejtor i të Ardhurave Vendore, për shkak se:

- Ka planifikuar me rezerva dhe nuk ka rakorduar taksat nga popullata për pastrimin, pasurinë, ndriçimin, gjelbërimin dhe hapësirat publike për vitet 2008 deri 2011.

- Nuk ka ndjekur arkëtimin e taksës së tokës bujqësore për periudhën 2008 deri 2011,

- Nuk ka zbatuar procedurat ligjore ndaj debitorëve për vitin 2008 dhe 2011, për veprime të kryera në kundërshtim me kërkesat ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemimin e taksave vendore” i ndryshuar.

d) Largim nga shërbimi civil” neni 25, pika 3, germa d

1. Zj. [REDACTED] me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës për shkak se:

- Ka lejuar përdorimin e fondeve buxhetore pa miratim nga Këshilli i Bashkisë në pesë tendera me vlerë 16,785 mijë lekë, në kundërshtim me nenin 32/f, të ligjit nr. 8552, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, si dhe nenin 15 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

- Nuk janë kryer inventarët fizikë dhe nuk janë azhurnuar llogaritë kontabël të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për vitin 2008 deri në vitin 2011,

- Nuk ka ndjekur arkëtimin e detyrimeve debitorë dhe nuk ka informuar, sipas periudhave të mbylljes së bilanceve vjetore,

- nuk ka ndjekur regjistrimin e pronave dhe asetëve të bashkisë në kontabilitet,
- nuk ka arkëtuar në kohë qiranë e objekteve dhe mos aplikimin e penalteteve sipas kushteve të kontratës, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 i ndryshuar dhe ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008.
- ka lejuar veprime për blerjet e vogla, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në UKM nr 2 datë 19.2.1996 “Për blerjet me vlera të vogla” i ndryshuar dhe nenin 12/3 të ligjit nr. 10 296 datë 8.07.2010.

2. Z. [REDAKTUAR] me detyrë kryeinspektor i INUV.

- Për mos zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës” i ndryshuar, dhe Udhëzimit të KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërtimeve” i ndryshuar,
- për të meta e mangësi, në funksionimin e INUV pa hartuar e miratuar programe vjetore e mujore, në mos kthimin e përgjigjes për rreth 148 ankesave, brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 30 ditësh, si dhe në mos ndjekjen e arkëtimit të një pjese të gjobave të vendosura.

Shënim:

- Për [REDAKTUAR] me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Mbledhjes së të Ardhurave për periudhën janar deri në muajin prill 2008, nuk është rekomanduar masë disiplinore për shkak pasi periudha e punës për të cilin janë konstatuar shkelje është e vogël, e largët dhe është larguar nga institucioni.
- Për [REDAKTUAR] në cilësinë e ish kryetarit të komisionit të inventarizimit pasurisë për vitin 2008, nuk është propozuar masë disiplinore pasi periudha e punës për të cilin janë konstatuar shkelje është e vogël, e largët dhe është larguar nga institucioni.
- Për [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me detyrë anëtarë të KVO nuk është rekomanduar gjobë për parregullsi në tenderë, sepse për [REDAKTUAR] është rekomanduar masë “ulje në detyrë 1 vit”, kurse për [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] është propozuar masë “vërejtje me shkrim”.

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281 i ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar me ligjin nr. 10078, datë 16.02.2009, neni 50/1, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Drejtorisë Juridike, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, për personat si më poshtë:

- 1. Z.** [REDAKTUAR] me detyrë specialist në Sektorin e Zhvillimit të Tokës, në cilësinë e ish-drejtorit Drejtorisë së Kontrollit e Zhvillimit Urban dhe ish-sekretarit të KRRT-së, për periudhën 10.6.2010 – 08.4.2011,
- 2. Zj.** [REDAKTUAR] me detyrë specialiste juriste në Sektorin e Zhvillimit të Tokës, në cilësinë e ish-drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit e Zhvillimit Urban dhe ish-sekretares së KRRT-së, për periudhën 30.4.2008 – 10.6.2010,
- 3. Zj.** [REDAKTUAR] me detyrë drejtor i Drejtorisë Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e ish-drejtorit të komanduar të Drejtorisë së Kontrollit e Zhvillimit Urban dhe ish-sekretares së KRRT-së, për periudhën 05.01.2009 – 15.12.2009,

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatmir Zilja, Xhevdet Haxhiu, Margarit Stefa, Halil Isufi, Hysen Metko dhe Xhemal Luka. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Bajram Lamaj, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT